



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:072884

Datë: 15.12.2023

Numri i dokumentit: 05077143

P.nr.1402/23

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Penal, me gjyqtarin Ertan Sejfulla, praktikanten Fahrije Ademi, në çështjen penale kundër të pandehurit K.P, për shkak se ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1618/23 datë 02.03.2023, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, më datë 15.12.2023, jashtë seancës, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 1618/23 datë 02.03.2023, andaj gjykata konform nenit 495 të KPP-së, kjo gjykatë jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

Kundër të pandehurit:

**K.P**, nga i ati ..... dhe nena ..... e vajzërisë ....., i lindur me ....., ne ....., me vendbanim ne ....., ....., rr.”.....”, ka te kryer shkollën ....., i pa ....., i gjendjes se ....., i identifikuar me numër personal ....., Shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës, posedon numrin e telefonit .....

### ESHTE FAJTOR

S e p s e:

- Me datë 02.02.2023 rreth orës 07:25min,ne rr.”.....” ne ....., me dashje dhe vetëdije e me qellim te shkaktimit te frikës seriozisht kanos personin tjetër se do ti shkaktoj ndonjë te keqe dhe atë te dëmtuarin F.H ne atë mënyrë deri sa i dëmtuari F.H ishte ne veturën e tij “.....”, saktësisht përballë shkollës “.....”, përballë tij ishte ndalur ne veture ..... me hiri, ku vozitësi i veturës tani i pandehuri K.P e kishte hapur xhamin e veturës dhe seriozisht e ka kanosur te dëmtuarin me fjalët “*qysh po ma nxënë rrugën, tash te tregoj unë ty*” dhe e kishte dëgjuar duke e repetimin e armës dhe një femër e cila ishte me te ka reaguar duke i thënë “*më më kujdes*” dhe me pas dy palët ishin larguar ne drejtime te ndryshme, me çka tek i dëmtuari ka shkaktuar frike dhe pasiguri për jetë -.

- Me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale Kanosja neni 181 par 1.te KPRK-se.

Andaj gjykata në bazë të neneve 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 të KPRK, si dhe neneve 364 dhe 495, të KPPK-së, i shqipton:

### **DËNIM ME GJOBE**

Të pandehurit **K.P** i shqipton **Dënim me Gjobë** në shumën prej **300 (treqind) Euro**, të cilin dënim, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par 3 të KPRK-së, do të ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

I pandehuri dënimin e shqiptuara, mund ta paguajë, me dy këste. Mundësia e pagesës me këste do te revokohet nëse personi e dënuar nuk e paguan këstin me kohë.

Obligohet i pandehuri që ti paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për paushallin gjyqësor në shumë prej 30.00 (tridhjetë) €, ndërsa në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 20.00 (njëzet) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar F.H. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr. 1618/23 datë 02.03.2023, ndaj të pandehurit K.P, për shkak se ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par 1 të KPRK-së dhe njëherësh nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se te pandehurit vërtetë e kane kryer veprën penale, për të cilën akuzohen.

Gjykata pasi shqyrtoi përmbajtjen e aktakuzës dhe kërkesës për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor nga ana e organit të ndjekjes, gjeti se të njëjtat janë përpiluar në përputhje me nenin 493 të KPP-së, andaj erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet nga neni 495 i KPP-së, që në këtë çështje penale pa u mbajtur fare shqyrtimi gjyqësor të marrë vendim për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor ndaj të pandehurve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë në bazë të: Raporti i oficerit i dt.02.02.2023, deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit F.H, deklarata e dëshmitares A.B. si dhe në bazë të dokumentacionit me shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lartë, gjykata konstaton se i pandehuri, është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Kanosje nga neni 181 par 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Gjykata, vlerësoi se me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim të nenit 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngrit moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 paragrafi 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të Ligjit nr. 08/L-109.

Vendimin që pala e dëmtuar të udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civilë gjykata e mori në bazë të nenit 462 të KPP-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 364 e 495, të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal

P.nr. 1402/23 datë 15.12.2023

Gjyqtari,  
Ertan Sejfulla

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Të pandehurit ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.